



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 15.07.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:13 dhe mbaroi në orën 16:26.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*

Shënim: Të gjithë pjesëmarrësit e tjerë dalin nga salla e mbledhjes dhe nuk marrin pjesë në vijimin e mbledhjes.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve:

1. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relator Marçela Shehu;
2. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relator Marçela Shehu
3. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relator Marçela Shehu;
4. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}”, relator Marçela Shehu;
5. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relator Ilir Toska;
6. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}”, relator Ilir Toska;
7. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}”, relator Alban Toro;
8. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relator Alban Toro;
9. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relator Alban Toro;
10. “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të kandidates znj. {...}”, relatore Alban Toro;

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Mirë se na erdhët, magjistratët këtu!

Sot në fakt, siç kemi vënë në dijeni edhe përmes publikimit të rendit të ditës, çështja më kryesore dhe më e rëndësishmja që Këshilli është mbledhur, është lidhur me shqyrtimin e 10 projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin si gjyqtar të 10 kandidatëve, të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2017-2018 dhe konkretisht janë këto kandidatë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, ky është një hap mjaft i rëndësishëm dhe mban mjaft rëndësi sepse e para, është fillimi i procesit të caktimit në detyrë të magistratëve, të kandidatëve magistratë dhe është një gjë që ne e kemi deklaruar edhe në mbledhjet e mëparshme, është një nga vendimet më të rëndësishme, pasi për shkak të efekteve dhe mungesave që ka krijuar ‘vettingu’, nëpërmjet këtij vendimi, ne pa diskutim do ndikojmë në situatën e vakancave në sistem. Gjithashtu, ai i hap rrugën edhe emërimit në detyrë të këtyre magistratëve të rinj.

Sikurse jeni në dijeni, lidhur me procedurën që Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvillon për verifikimin e kritereve ligjore, ku përfshihen verifikimet e pasurisë dhe verifikimin e figurës, në bazë të rregullores që kemi miratuar mbi procedurën dhe mënyrën si bëhet ky verifikim, është një verifikim i cili kërkon përdorimin, për hartimin e raportit, të dokumenteve të cilat janë dokumente të klasifikuara. Që do të thotë që, në momentin që këto lloj dokumente janë të klasifikuara, të vetmit persona që kanë të drejtë që të kenë dijeni lidhur me këto dokumente, duhet të kenë një Certifikatë Sigurie në zbatim të ligjit.

Për këto arsye, neve sot e kemi të pamundur që mbledhjen ta zhvillojmë me dyer të hapura, pra personat që janë të pranishëm këtu të mundohen ta vazhdojnë qëndrimin e tyre, pasi raportet që diskutohen janë raporte që përmbajnë informacione të klasifikuara. Për këtë do ju lutesha që të gjithë pjesëmarrësit, ato që nuk kanë Certifikatë Sigurie të largohen, për t’ia lënë Këshillit mundësinë e vazhimit të diskutimit.

(Largohen nga salla e mbledhjes të pranishmit si: magistratët e diplomuar, pjesëmarrësit nga administrata e Këshillit apo përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare që asistojnë mbledhjet plenare të Këshillit.)

Atëherë, në vijim, po kalojmë pa humbur kohë, lidhur me relatimin e raporteve përkatës, duke filluar me relatorin zonjën Marçela Shehu, e cila do vijojë me relatimin e projekt-aktit të parë.

Marçela Shehu: Po, faleminderit Kryetare!

Relacioni i parë lidhet me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin si gjyqtare, të kandidatës {...}.

Ky Relacion hartohet bazuar në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e

verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Lidhur me procedurën e verifikimit: Procedura e verifikimit për rekrutimin si gjyqtare të kandidates {...} filloi me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, datë 05.06.2019, nëpërmjet të cilit, me short, si relator u caktua anëtarja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Shehu.

Kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit për relatoren, duke mos paraqitur asnjë kërkesë për përjashtim apo pretendim në lidhje me relatoren apo me ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidatja u njoftua lidhur me dokumentacionin që duhet të plotësonte. Duhet theksuar që një pjesë e dokumentacionit, kandidatja e ka plotësuar dhe dorëzuar përpara fillimit zyrtarisht të procedurës së verifikimit, në kushtet kur Këshilli, për t'i paraprirë mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm, ka konsideruar kërkimin e këtij dokumentacioni, qoftë nga kandidatja, ashtu edhe nga subjektet e përcaktuara nga ligji.

Lidhur me verifikimi i kushtit të emërimit: Gjatë verifikimit u konstatua se kandidatja {...} plotëson kushtin për t'u emëruar si gjyqtare në bazë të nenit 35 të ligjit nr. 96/2016, pasi rezultoi të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018, referuar kjo shkresave përkatëse.

Lidhur me verifikimin e kriterëve të emërimit: Gjatë verifikimit u konstatua se kandidatja {...} përmbush kriteret për t'u emëruar gjyqtare bazuar në të dhënat e grumbulluara, si më poshtë:

U konstatua se zonja {...} përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, edhe të emërimit si gjyqtare. Për këtë, u mbajt në konsideratë ligji i kohës së pranimit të kandidates në formimin fillestar si dhe, ligji i momentit të realizimit të verifikimit.

Nga informacionet e mbledhura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës rezultoi se kandidatja:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar, ndërsa nuk ka të dhëna për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) është shtetase shqiptare, referuar të dhënave për përbërësit e gjendjes civile të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;

c) ka plotësuar kriterin arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”;

d) nuk ka të dhëna të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

dh) nuk rezulton të jetë e larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo të ketë masë disiplinore në fuqi;

e) nuk ka të dhëna të jetë anëtare e partive politike;

ë) nuk mund të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtoreshë ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara ‘90, referuar moshës së saj (pasi rezulton që kandidatja është e datëlindjes 16.10.1987);

f) nuk ka të dhëna të ketë qenë bashkëpunëtoreshë, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

Lidhur me kriterin e përvojës profesionale aktive me kohë të plotë, të paktën tre vjet, në sistemin gjyqësor, në administratën publike, etj., rezulton se ky kriter është i paaplikueshëm për këtë kandidatë si dhe për të gjithë kandidatët për të cilët do të relatohet në seancën e sotme, për shkak se nuk ka qenë kriter ligjor në kohën e kandidimit për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Lidhur me verifikimin e kriterëve të emërimit si gjyqtar sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” rezulton se: Kandidatja {...} u verifikua se përmbush kriteret e emërimit sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016.

Për këtë, referuar shkresave të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se:

a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 91.26 % të pikëve, pra “është diplomuar me të paktën 70% të pikëve maksimale të mundshme”;

b) është vlerësuar me 598 pikë, domethënë “Shumë mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra “është vlerësuar minimalisht “Mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”.

Lidhur me verifikimin e kriterit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016, rezulton se:

Kandidatja {...} kalon testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të nenit të sipërcituar. Referuar Raportit të depozituar nga ILDKPKI, rezulton se, lidhur me kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pasur korrespondencë edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, dhe nuk rezultojnë të dhëna të tjera të cilat mund të kenë mospërputhje me ato të dhëna që u parashtruan në raportin e ILDKPKI.

Në këto kushte, në verifikim të të gjitha këtyre elementëve, rezulton se:

Kandidatja ka burime financiare të ligjshme, burimet financiare të saj justifikojnë pasuritë e saj;

Ajo nuk rezulton të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

Nuk rezulton që kandidatja të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

Nuk rezulton që kandidatja të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Lidhur me verifikimin e kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016, rezulton se:

Kandidatja {...} kalon testin e verifikimit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të këtij neni.

Nga të gjitha informacionet e ardhura nga institucionet shtetërore kompetente, rezulton se: Për kandidaten nuk ka të dhëna të jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë; nuk ka të dhëna për deklarim të pasaktë ose jo në përputhje me ligjin; nuk ka të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligj zbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime të ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës, të përfshirë

drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta; nuk ka të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo të dyshuar për kryerjen e veprave penale); nuk ka të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara apo të pezulluara, në të cilat të përmendet emri i saj; nuk rezulton të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit para datës 2 korrik 1991; nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtore, informatore apo të jetë agjente e shërbimeve të inteligjencës.

Në këto kushte, si konkluzion, relatorja e çështjes ka arritur, se bazuar në verifikimet e kryera për kandidaten {...}, nuk rezultojnë të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare, prandaj si propozim është paraqitur që çështja të kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit, duke i propozuar Këshillit që të kualifikojë për emërim kandidaten {...}, diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë për votim propozimin e bërë nga relatori?

Marçela Shehu: Si fillim, sipas rregullores voton relatorja e çështjes, më pas anëtarët e Komisionit, më pas vijon votimi normalisht.

Naureda Llagami: Jemi dakord? Kemi ndonjë koment? Diskutim?

Ilir Toska: Tek projektvendimi, tek pika 2 do desha të korrektohet që të jetë në përputhje edhe me përcaktimet e bëra në vendimin për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit. Mendoj që të formulohet në këtë mënyrë: “2. Një kopje e arsyetuar e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates dhe të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.” Një gjë e tillë është përcaktuar në vendimin 75, datë 23.05.2019 në Kreun VIII, në Kreun VII.

Atëherë, formulimi që unë propozoj në këto momente është “Një kopje e arsyetuar e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates dhe të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve”. Një gjë e tillë është përcaktuar tek vendimi 75, tek Kreu VII (Vendimi i verifikimit, E drejta e ankimit). Pika 2 thuhet: “Vendimi i verifikimit njoftohet sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit për Statusin dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit, shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, jeni dakord me propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit?

Dakord. Atëherë projekt-akti do hidhet në votim sipas procedurës së përcaktuar në rregullore, së bashku me propozimin e bërë dhe të miratuar nga...

Medi Bici: Pika 2 dhe pika 3 e vendimit e shprehin atë. Edhe vendimi, vendimet e arsyetuara jepen. Edhe kjo botohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si ta çmoni.

Brunilda Kadi: Për t’u sqaruar.

Pra ky vendimi që propozohet, ky projektvendim është me këtë përmbajtje dhe me shtesën që propozon Iliri, që të shtohet kjo. Që do të thotë, -po ai vendimi i arsyetuar do ketë të njëjtin dispozitiv, apo jo?

Ka kuptim pastaj që ai vendim i arsyetuar të ketë në dispozitiv këtë gjënë?

Ilir Toska: Vendimi i arsyetuar ka urdhërimin përkatës për kualifikimin dhe vijimin e mëtejshëm të procedurave të emërimit. Pjesë e atij vendimi nuk është ky urdhërim. Ky është miratimi i raportit dhe vendimi sipas rregullores duhet të arsyetohet brenda 5 ditëve sepse një kopje i njoftohet kandidatit. Kandidati ka të drejtën e ankimit, në rastin e një vendimi të pafavorshëm.

Brunilda Kadi: Pra dispozitivi i këtij vendimi tani nuk do jetë identik me dispozitivin e vendimit të arsyetuar?

Ilir Toska: Dispozitivi është kualifikimi dhe vijimi i procedurave të emërimit.

Brikena Ukperaj: Në fakt, ajo që ne kemi vënë në rregullore ka qenë përsëritje e nenit 98, pika 2 e ligjit. Kështu që ligji e ka të përcaktuar. Do thotë që, aktet administrative individuale të Këshillit në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve gjyqësorë bëhen publik në faqen zyrtare të internetit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, pra e ka ligji të përcaktuar. Është e nevojshme që ne duhet ta vendosim në vendim dispozitivin e vendimit? ...Statusin e gjyqtarëve për shembull.

(Anëtarët diskutojnë ndërmjet tyre pa ndezur mikrofonat.)

Medi Bici: Unë jam i mendimit që dispozitivi i projektvendimit duhet të rrijë ashtu siç është dhe vendimi të jetë i arsyetuar sepse nuk ka kuptim. Kur një vendim është i arsyetuar, në dispozitiv thuhet që një kopje e vendimit të arsyetuar t'i jepet kandidatit. Gjithashtu edhe anonimatit është pjesë e procedurës, e bën administrata. Kështu që mendoj që projektvendimi që ka sjellë Komisioni është në rregull dhe duhet miratuar pa ndryshimin që propozon – dispozitivin – që propozon zoti Ilir.

Ilir Toska: Mirë atëherë, po tërhiqem, meqenëse shumica e anëtarëve konsiderojnë që ky propozim i bërë nga ana ime është i pavend dhe mundet të procedojmë me projektvendimin në mënyrën se si ka ardhur fillimisht. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e projektvendimit sipas rregullores?

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në relatimin e projektvendimit të dytë. Edhe ky relati/projekt-akt do të relatohet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Edhe me kandidaten {...} Komisioni dhe relatorja ka ndjekur të njëjtën procedurë për verifikimin. Kjo procedurë filloi me vendimin nr. 82, datë 05.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor me caktimin e relatores, për të cilën kandidatja nuk pati asnjë kundërshtim, as për relatoren as për anëtarët e tjerë të Këshillit.

Pas mbledhjes së informacionit përkatës rezultoi se kandidatja {...} përmbush kushtin e emërimit si gjyqtare, sipas nenit 35 të ligjit 96/2016, pasi rezulton të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018.

Gjithashtu, rezulton se, kandidatja {...} përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe për rrjedhojë edhe të emërimit si gjyqtare.

Besoj nuk është e rëndësishme t'i përsërisim, duke qenë se janë po ato që u evidentuan në relacionin e parë, për kandidaten {...}.

Rezulton gjithashtu se kandidatja përmbush kriteret e emërimit si gjyqtar sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016. Për këtë, referuar informacionit përkatës nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se:

a) kandidatja është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 92,83 të pikëve, pra “është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”;

b) është vlerësuar me maksimalen e pikëve (600), domethënë “Shumë mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra “është vlerësuar minimalisht “Mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”.

Gjithashtu rezulton se: Kandidatja {...} kalon testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016.

Referuar raportit të paraqitur nga ILDKPKI, informacioneve të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Doganat, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, rezulton se, në lidhje me pasurinë e kandidates, nuk rezulton që ajo të jetë para ndonjë prej rasteve të shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

a) burimet financiare të kandidates të mos justifikojnë pasuritë e saj;

b) kandidatja të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) kandidatja të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidatja të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Gjithashtu rezulton se kandidatja {...} kalon testin e verifikimit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016.

Nga të gjitha informacionet e ardhura nga institucionet shtetërore kompetente, rezulton se për kandidate:

a) nuk ka të dhëna të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

b) nuk ka të dhëna për deklaram të pasaktë ose jo në përputhje me ligjin;

c) nuk ka të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligj zbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime të ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;

d) nuk ka të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm;

e) nuk ka të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara apo të pezulluara, në të cilat të përmendet emri i saj.

Nuk rezulton të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtoe ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991;

Nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtoe, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës.

Në këto kushte, relatorja ka vlerësuar, më pas edhe Komisioni, që nuk rezultojnë të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e kandidates {...}, ndaj propozoj që kjo çështje të kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke i propozuar Këshillit kualifikimin e kësaj kandidateje.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Kemi ndonjë diskutim apo koment lidhur me relacionin e hartuar nga zonja Shehu?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas rregullores?

Atëherë, kalojmë në votim, duke filluar me relatoren.

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk është regjistruar.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me diskutimin e projekt-aktit në vijim, që është për zonjën {...} dhe relatore është sërish zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Edhe për kandidaten {...} është realizuar e njëjta procedurë, bazuar në përcaktimet e ligjit 96/2016 dhe në vendimin 75, datë 23.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës për relatorin. Nuk pati ndonjë kundërshtim lidhur me relatorin apo me ndonjë anëtar të Këshillit.

Ka depozituar pranë Këshillit të gjithë autorizimet dhe dokumentacionin e nevojshëm. Janë realizuar korrespondencat përkatëse me institucionet shtetërore.

Është realizuar verifikimi i kushtit të emërimit.

Rezulton se kandidatja {...} plotëson kushtin për t'u emëruar si gjyqtare në bazë të nenit 35 të ligjit nr. 96/2016 pasi rezulton të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018.

Rezulton se përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, edhe të emërimit si gjyqtare.

Rezulton gjithashtu se kandidatja kalon edhe testin, përmbush kriteret e emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35. Ajo rezulton që:

a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 92,33% të pikëve, pra “është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”;

b) është vlerësuar me (600) pikë, domethënë “Shumë mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

Rezulton se kandidatja kalon testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35. Nga të gjithë informacionet e ardhura nga ILDKPKI, nga Drejtoria e Tatimeve, e Doganave, etj., rezulton se, në lidhje me pasurinë e kandidates: nuk rezulton që ajo të jetë përpara ndonjë prej rasteve të shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

a) burimet financiare të kandidates të mos justifikojnë pasuritë e saj;

b) të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidatja të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Lidhur me verifikimin e kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, rezulton se kandidatja e kalon edhe këtë test. Nga të gjitha verifikimet e kryera rezulton se nuk ka të dhëna që cenojnë figurën apo integritetin e kandidates, të tilla që mund ta bëjnë atë të papërshtatshme për t’u kualifikuar dhe për t’u emëruar si gjyqtare.

Në këto kushte, relatorja si dhe me miratimin paraprakisht të Komisionit, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të shqyrtojë në mbledhjen plenare këtë propozim dhe të vendosë kualifikimin e kandidates {...} për emërim si gjyqtare dhe vijimin e procedurave të mëtejshme. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime lidhur me raportin, propozohet kalimi në votim sipas rregullores.

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutim të kandidatit {...} dhe për këtë relator është zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Edhe për kandidatin {...} është zhvilluar e njëjta procedurë verifikimi, bazuar në nenin 35, 32 të ligjit 96/2016, me vendimin 75, datë 23.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidati u njoftua për fillimin e procedurës për relatorin dhe nuk pati asnjë kundërshtim lidhur me relatorin apo ndonjë anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidati ka plotësuar të gjithë dokumentacionin që i është kërkuar. Është zhvilluar edhe korrespondenca përkatëse me institucionet shtetërore kompetente.

Rezulton se kandidati {...} plotëson kushtin e emërimit, pasi rezulton të ketë përfunduar studimet dhe është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundimin e vitit akademik 2017-2018.

Rezulton gjithashtu që ai të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe për rrjedhojë edhe të emërimit si gjyqtar.

Gjithashtu është realizuar evidentimi i kriterëve të emërimit sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35. Rezulton se kandidati {...} përmbush kriteret e emërimit si gjyqtar, parashikuar në pikën /a/ dhe /b/.

a) ai është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 90,35% të pikëve, pra “është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”;

b) është vlerësuar me maksimalen e pikëve (600), domethënë “Shumë mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra “është vlerësuar minimalisht “Mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”.

Rezulton gjithashtu se: Kandidati {...} kalon testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit.

Nga gjithë informacioni i ardhur nga ILDKPKI dhe nga institucionet e tjera shtetërore, që mund të kenë të dhëna lidhur me pasurinë e tij, rezulton se kandidati nuk ndodhet para asnjë rasti skualifikues lidhur me pasurinë e tij.

Gjithashtu është realizuar edhe verifikimi i kriterit të figurës, sipas shkronjës /c/ të pikës 1, të nenit 35.

Është realizuar korrespondenca me institucionet kompetente shtetërore. Nga të gjitha informacionet e ardhura, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë të cilat do të cenonin lidhur me figurën e kualifikimit të Kandidatit {...}.

Në këto kushte, Këshillit të Lartë Gjyqësor i propozohet të shqyrtojë në mbledhje këtë relacion dhe të vendosë kualifikimin e kandidatit {...} për emërim si gjyqtar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse ne nuk kemi diskutime dhe komente lidhur me relacionin e propozuar nga zonja Shehu, kalojmë në vendimmarrje?

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kalojmë tek projektvendimi i radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar, të kandidatës, znj. {...}, i cili do relatohet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Ky relacion përpilohet bazuar në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të ligjit për Statusin si dhe në vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 e Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Procedura e verifikimit për kandidaten {...} filloi me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, datë 05.06.2019.

Kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës dhe për relatorin e çështjes. Nuk pati vërejtje dhe as kërkesë për përjashtim për ta apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidatja plotësoi të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kuadër të procedurës së verifikimit, ndërkohë që një pjesë e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit është plotësuar më herët nga kandidatja përmes kërkesave të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa procedura e verifikimit, duke zbatuar drejtpërdrejt ligjin, ka filluar më herët, referuar faktit që Kandidatja {...} është diplomuar në vitin akademik 2017-2018 dhe prej disa muajsh është në pritje për t’u emëruar.

Nga verifikimet e kryera rezulton që kandidatja të përmbushë kushtin sipas nenit 35 të ligjit për emërimin e saj si magjistrat, pra të ketë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Po kështu, nga verifikimet e kryera rezulton që kandidatja të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, edhe të emërimit si gjyqtare.

Ndërsa rezulton nga të gjithë të dhënat e grumbulluara, apo ato që duhet të prezumohen si të vërteta, rezulton që ajo ka zotësi të plotë për të vepruar, ndërsa nuk ka të dhëna për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë; është shtetase shqiptare referuar të dhënave për përbërësit e gjendjes civile të dokumentuar në regjistrin kombëtar të gjendjes civile; ka plotësuar kriterin arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar ligjit të kohës; nuk ka të dhëna të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë; nuk ka të dhëna të ketë qenë më parë në marrëdhënie pune dhe, për pasojë, të mund të jetë e larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo të ketë masë disiplinore në fuqi; nuk ka të dhëna të jetë anëtare e partive politike; nuk mund të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtorë ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, referuar moshës së saj; si dhe nuk ka të dhëna të ketë qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

Sa i përket kriterit të përvojës profesionale aktive me kohë të plotë, të paktën tre vjet, siç kërkohet në shkronjën /ç/, të nenit 28, të ligjit për Statusin e gjyqtarëve, ky kriter është i pa aplikueshëm në rastin konkret referuar faktit të pranimit të saj në formimin fillestar, përveçse tashmë, kandidatja ka përfunduar edhe formimin fillestar dhe është diplomuar tashmë.

Rezulton nga verifikimet e kryera se kandidatja plotëson kriteret sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

a) ajo është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 91,11 % të pikëve;

b) po kështu është vlerësuar me maksimalen e pikëve (600), domethënë “Shumë mire”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

Po kështu, rezulton që kandidatja të plotësojë kriterin e pasurisë sipas /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për këtë, referuar raportit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe informacioneve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ku nga tërësia e

informacioneve të marra, në lidhje me pasurinë e kandidatës nuk rezultojnë që ajo të jetë përpara ndonjë prej rasteve të shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

- a) burimet financiare të kandidatit të mos justifikojnë pasuritë e saj;
- b) kandidatja të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;
- c) kandidatja të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- ç) kandidatja të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Po kështu, nga verifikimet e kryera, rezultojnë që kandidatja të kalojë edhe kriterin e figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referuar për këtë raporteve të marra nga agjencitë shtetërore ligj zbatuese, ku referuar këtyre informacioneve nuk rezultojnë që kandidatja të jetë përpara ndonjë prej rasteve të shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

- a) ajo të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- b) të ketë lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë me krimin e organizuar.
- c) të ketë qenë anëtare bashkëpunëtore ose e favorizuar nga sigurimi i shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- ç) si dhe të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës.

Referuar verifikimeve të kryera, pas relativitetit të rastit përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, u konsiderua që verifikimi është i plotë, prandaj unë si relator i çështjes i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që kandidatja të kualifikohet për emërim dhe të vijohen procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si gjyqtare. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë sugjerim lidhur me relacionin e relatuar nga zoti Toska?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë, sipas rregullores. Zoti Toska!

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidatin {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 ...

Edhe një herë, ndjesë! Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, kalojmë me projekt relacionin tjetër që ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin për gjyqtar të kandidatit {...}, relator i të cilit është zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe ky relacion, sikundër relacionet e mëparshme është përpiluar bazuar në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019.

Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin gjyqtar të kandidatit {...} ka filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, datë 05.06.2019, përmes të cilit unë jam caktuar si relator për këtë çështje.

Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e procedurës dhe për relatorin e çështjes. Nuk ka ngritur ndonjë pretendim apo kërkuar përjashtimin tim apo të ndonjë prej anëtarëve të tjerë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidati është njoftuar dhe ka paraqitur rregullisht të gjithë dokumentacionin që duhet të dorëzonte referuar legjislacionit në fuqi, një pjesë e të cilit duhet thënë që është dorëzuar më herët nga ai, në konsideratë të faktit se Këshilli i Lartë Gjyqësor, për vijimin sa më parë të procedurave të emërimit të kandidatëve për gjyqtar, që janë emëruar në vitin 2018, ka kërkuar duke zbatuar drejtpërdrejt ligjin, plotësimin e këtij dokumentacioni, qoftë nga kandidati ashtu edhe nga organet e tjera që përcaktohen në nenin 28 të ligjit.

Lidhur me verifikimin e kushteve të emërimit, nga verifikimi është konstatuar se kandidati {...} e plotëson këtë kusht, pasi është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës sikurse përcaktohet në nenin 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Po ashtu është verifikuar se kandidati plotëson edhe kriteret e tjera për t’u emëruar gjyqtar, qoftë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe për rrjedhojë edhe të emërimit si gjyqtar, duke pasur parasysh për këtë se kandidati rezulton të ketë zotësi të plotë për të vepruar ndërsa nuk ka të dhëna për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë; është shtetas shqiptarë referuar të dhënave për përbërësit e gjendjes civile të dokumentuar në regjistrin kombëtar të gjendjes civile; ka plotësuar kriterin arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktuar sipas ligjit të kohës (ligjit 8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”); nuk ka të dhëna të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë; nuk ka të dhëna të ketë qenë më parë në marrëdhënie pune dhe, për pasojë, të mund të jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo të ketë masë disiplinore në fuqi; nuk ka të dhëna të jetë anëtar i partive politike; nuk mund të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, referuar moshës së tij; nuk ka të dhëna të ketë qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

Lidhur me verifikimin e kriterëve të përcaktuara nga shkronjat /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se kandidati {...} verifikohet të përmbushë këto kriterë:

a) ndërsa është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 92.51 % të pikëve;

b) si dhe është vlerësuar me maksimalen e pikëve (600), domethënë “Shumë mire”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

Po kështu, nga verifikimet e kryera rezulton që kandidati të kalojë testin e pasurisë sipas /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku referuar raportit të dërguar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe informacionet e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, rezulton që kandidati të mos jetë përpara ndonjë prej rasteve të shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

a) burimet financiare të kandidatit të mos justifikojnë pasurinë e tij;

b) kandidati të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) kandidati të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidati të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Po kështu, nga verifikimi i kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga informacionet e marra nga agjencitë shtetërore ligj zbatuese, nuk rezulton që për kandidatin të ketë të dhëna për shkualifikimin e tij, pra që:

a) ai të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

b) të ketë lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë me krimin e organizuar.

c) të ketë qenë anëtar bashkëpunëtore ose i favorizuar nga sigurimi i shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

ç) apo të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

Procedura e verifikimit u verifikua në mbledhjen e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, sa i përket plotshmërisë së saj. U konsiderua që është e plotë, prandaj unë si relator i çështjes i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor kualifikimin për emërim të kandidatit {...} dhe vijimin e procedurave të mëtejshme për emërimin e tij si gjyqtar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi komente ose sugjerime lidhur me relacionin e propozuar nga zoti Toska?

Atëherë, duke qenë se nuk kemi, kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas rregullave të përcaktuara në rregullore. Zoti Toska!

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidatin {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, kalojmë me projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit, z. {...}, relacioni i të cilit do të relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Po! Faleminderit!

Ky relacion përpilohet në përputhje me nenin 32, 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e

Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, 23.05.2019, me përcaktimin e relatorit konform vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, datë 05.06.2019, nga ana e këtij të fundit u kryen veprimet paraprake dhe u konstatua se nuk kishte asnjë shkak përjashtimor për të, anëtarët e Komisionit apo anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijoi procedurën për shpërndarjen e dokumentacionit tek institucionet si dhe duke njoftuar kandidatin për plotësimin e akteve përkatëse.

Më tej u kalua tek verifikimi i kushteve të emërimit, nga i cili rezulton që kandidati {...} plotëson kushtin për t'u emëruar si gjyqtar në bazë të nenit 35 të ligjit 96/2016, pasi rezulton që është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar.

Gjithashtu, më pas u kalua tek verifikimi i kriterëve të emërimit, nga aktet të cilat janë administruar, u verifikua se ai përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe për rrjedhojë edhe të emërimit si gjyqtar; ka zotësi të plotë për të vepruar; është shtetas shqiptar; ka plotësuar kriterin arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës; nuk ka të dhëna të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë; ka të dhëna të ketë qenë më parë në marrëdhënie pune dhe, nga verifikimet rezulton se nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo të ketë masë disiplinore në fuqi; nuk ka të dhëna të jetë anëtar i partive politike; nuk mund të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, referuar moshës së tij të re.

Në lidhje me kriterin e përvojës profesionale, ky i fundit është i pa aplikueshëm sepse në kohën e fillimit të arsimimit të tij, nuk ka qenë kriter ligjor në kohën e kandidimit për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Më pas u kalua në verifikimin e kriterit të emërimit si gjyqtar sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016, dhe nga aktet e administruara rezultoi se ai përmbush kriteret e emërimit si gjyqtar sipas /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35:

- a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 94,47% të pikëve, pra ka tejkaluar pragun minimal;
- b) është vlerësuar me (600) pikë, domethënë “Shumë mirë”.

Më pas bëhet verifikimi i pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kandidati {...}, në bazë të akteve të administruara kalon testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me pasurinë e kandidatit nga institucione të cilat në kompetencë të tyre kanë verifikimin e pasurisë, ka rezultuar se:

- a) burimet financiare të kandidatit e justifikojnë pasurinë e tij;
- b) kandidati nuk ka pasur pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;
- c) kandidati (*nuk*) të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- ç) kandidati (*nuk*) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Më pas është kaluar tek verifikimi i kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nga aketet e administruara, kandidati {...} rezulton se ka kaluar edhe këtë test të verifikimit të figurës sipas germës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Nga tërësia e informacioneve të marra nga institucionet ligj zbatuese dhe që secili ka verifikimin e figurës së personaliteteve të tilla, ka rezultuar që: nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë; nuk ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; apo të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit...”; apo të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

Në përfundim, ka rezultuar se bazuar në verifikimet e kryera për kandidatin {...}, nuk rezultojnë të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e tij nga kandidimi për emërim si gjyqtar, prandaj çështja duhet të kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk kemi ndonjë sugjerim, koment mbi relacionin, kalojmë në procedurën e votimit? Zoti Toro!

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidatin {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar. 2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me projekt-aktin tjetër, pra projekt-aktin për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidates, znj. {...}. Edhe për këtë është relator zoti Alban Toro.

Alban Toro: Ky relacion përpilohet në bazë të nenit 32, 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019. Me caktimin e relatorit konform vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor 82, 05.06.2019, ky i fundit, pasi konstatoi se mungonin shkaqet përjashtimore për anëtarët e Komisionit dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedoi me njoftimin e kandidatit si dhe dërgimin për plotësimin e dokumentacionit, si dhe dërgimin e akteve në institucionet ligj zbatuese.

Nga administrimi i këtyre akteve, u konstatua se kandidatja {...} plotëson kushtin për t’u emëruar si gjyqtare në bazë të nenit 35 të ligjit ...2016, pasi rezulton të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës.

Në vijim të verifikimit të kriterit të emërimit kandidatja {...}, nga aktet që u administruan, konfirmohet se përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të

zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, edhe të emërimit si gjyqtare.

Më pas u kalua në verifikimin e kriterit të emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ku nga administrimi dhe analiza e akteve është konstatuar se mbush kriteret e emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”.

Kandidatja {...} a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 90,11% të pikëve, pra ka tejkaluar nivelin minimal të pranimit; b) është vlerësuar me (598) pikë, domethënë “Shumë mirë”;

Më pas është kaluar tek verifikimi i kriterit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 dhe ka kaluar edhe këtë test duke vlerësuar edhe aktet të cilat janë administruar. Duke iu referuar raporteve të këtyre institucioneve, ka rezultuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Më pas është kaluar tek verifikimi i kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, dhe në këtë kuadër, kandidatja {...} e ka kaluar këtë test, gjithmonë duke analizuar dhe aktet që janë administruar dhe dërguar nga institucionet ligj zbatuese, kompetencë e të cilave është verifikimi i figurës së këtyre lloj zyrtarëve.

Në përfundim, bazuar në verifikimet e kryera për kandidaten {...}, nuk rezultojnë të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare, prandaj çështja duhet të kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, keni ndonjë koment, sugjerim lidhur me relacionin për kandidaten {...}, të relatuar nga zoti Toro?

Nëse jo, atëherë vijojmë me votimin e propozimit të bërë nga relatori sipas procedurës së përcaktuar në rregullore.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë me projekt-aktin tjetër, lidhur me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare të kandidates, znj. {...}. Edhe ky projekt-akt do relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Edhe ky relacion ky relacion përpilohet bazuar në nenin 32, 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019. Me përcaktimin e relatorit konform vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, 05.06.2019, ky i fundit, pra relatori, pasi konstatoi mungesën e shkaqeve përjashtimore për të, për anëtarët e Komisionit dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedoi me njoftimin e kandidatëve për plotësimin e dokumentacionit si dhe dërgimin e kërkesave për institucionet ligj zbatuese.

Procedura e verifikimit të kushtit të emërimit, ka rezultuar se kandidatja {...} plotëson kushtin për t'u emëruar si gjyqtare në bazë të nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Më pas është kaluar në verifikimin e kriterit të emërimit. Nga aktet e administruara ka rezultuar se kandidatja {...} përmbush kriteret e përgjithshme të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe për rrjedhojë edhe të emërimit si gjyqtare.

Më pas është kaluar në verifikimin e kriterit të emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit 96/2016, ku nga analiza e akteve të administruara në këtë kontekst është konstatuar se përmbush kriteret e emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit të lartpërmendur.

Kandidatja a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 95.85% të pikëve;

b) është vlerësuar me (600) pikë maksimale, domethënë “Shumë mire”;

Më pas është kaluar në verifikimin e kriterit të pasurisë sipas shkronjës /c/ të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016, dhe nga analiza e akteve në këtë kuadër është konkluduar se kalon edhe testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.

Nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me pasurinë e kandidatit nuk rezulton që ajo të jetë përpara ndonjë nga rastet e shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

a) burimet financiare të kandidatës të mos justifikojnë pasuritë e tij;

b) kandidati të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) kandidati të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidati të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Më pas është kaluar tek verifikimi i kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016 dhe nga analiza e këtyre akteve është konkluduar se kalon edhe testin e verifikimit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.

Në analizë të dokumentacionit të dërguar nga institucionet ligj zbatuese, nuk rezulton që kandidatja të jetë përpara ndonjë rasti të shkualifikimit nga kandidimi.

Në këtë kuadër është rekomanduar konkluzioni: Bazuar në verifikimet e kryera për kandidaten {...}, nuk rezultojnë të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e saj nga

kandidimi për emërim si gjyqtare, prandaj çështja duhet të kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse nuk kemi komente dhe sugjerime mbi relacionin e relatuar nga zoti Toro, kalojmë në votimin e projekt-aktit, në respektim të rregullores.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kalojmë në relatimin e projekt-aktit të fundit, që ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatës, znj. {...}. Dhe për këtë projekt-akt, relator është zoti Toro.

Alban Toro: Edhe ky relacion ky relacion redaktohet bazuar në nenin 32, 35 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019. Me përcaktimin e relatorit konform vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, 05.06.2019, relatori me konstatimin e mungesës së shkaqeve përjashtimore për të, anëtarët e Komisionit apo anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedoi me njoftimin e kandidatëve për plotësimin e akteve, si dhe dërgimin e kërkesave në institucionet ligj zbatuese, në kuadër të verifikimit të figurës dhe pasurisë.

Nga verifikimi i kushtit të emërimit, u konstatua se kandidatja {...} plotëson kushtin për t’u emëruar si gjyqtare në bazë të nenit 35 të ligjit 96/2016, pasi rezulton të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për profilin gjyqtar.

Më pas u kalua në verifikimin e kriterit të emërimit. Nga analiza e akteve që janë administruar për këtë qëllim u konstatua se kandidatja {...} përmbush kriteret e përgjithshme të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe për rrjedhojë edhe të emërimit si gjyqtare.

Në lidhje me verifikimin e kriterit të emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u verifikuan dhe u analizuan dokumentacione të cilat kanë lidhje me të. Nga analiza e tyre u konstatua se kandidatja {...} përmbush kriteret e emërimit si gjyqtare sipas shkronjave /a/ dhe /b/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ajo a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 92.49% të pikëve;

b) është vlerësuar me (600) pikë, domethënë “Shumë mire” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

Më pas është kaluar në verifikimin e kriterit të pasurisë sipas shkronjës /c/ të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016, dhe në këtë kuadër ajo, pasi është analizuar dokumentacioni përkatës, ka rezultuar se ka kaluar edhe testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo pasi janë analizuar tërësia e akteve të prodhuara nga institucione të cilat verifikojnë pasurinë dhe nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me pasurinë e kandidatës nuk rezulton që ajo të jetë përpara ndonjë nga rastet e shkualifikimit nga kandidimi, pra që:

a) burimet financiare të kandidatës të mos justifikojnë pasuritë e tij;

b) kandidati të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) kandidati të ketë dhënë një deklaram të rreme ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidati të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Më pas është kaluar në verifikimin e kriterit të figurës sipas shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 96/2016. Nga analiza e këtyre akteve të cilat kanë lidhje me këtë çështje është konkluduar se kandidatja {...} kalon edhe testin e verifikimit të figurës sipas

shkronjës /c/, të pikës 1, të nenit 35 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me figurën e kandidates, nuk rezulton që ajo të jetë përpara ndonjë prej rasteve të shkualifikimit nga kandidimi, pra që ajo:

- a) të jetë e dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- b) të ketë lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtorë ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr.45/2015;
- d) të ketë qenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

Përfundimisht rekomandohet se: Bazuar në verifikimet e kryera për kandidaten {...}, nuk rezultojnë të dhëna që mund të sjellin shkualifikimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare, prandaj çështja duhet të kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro për relatimin!

Atëherë, kemi ndonjë koment përpara se të kalojmë në votim propozimin e bërë nga zoti Toro?

Jo!

Atëherë, kalojmë për votim lidhur për propozimin e bërë nga zoti Toro për kandidaten {...}.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit, për mbledhjen!

Faleminderit Komisionit, për hartimin e projekt-akteve në një kohë rekord.

Për mbledhjen e ardhshme do ju njoftojë administrata.

Punë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare

Naureda Llagami

Redaktore-Stenografe

Rosalba Xhabrahimi